



MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

DITARI MUJOR

MARS
2022

MBËSHËTETJA PËR FERMERËT

- 3,2 MILIARDË LEKË
Skema Kombëtare
- + 500 MILIONË LEKË
Mbashtetje për natën nga Paketa e Rezistencës
- 3,7 MILIARDË LEKË
Në shërbim të bujqësisë e fermerëve

Aplikime rekord në Skemën Kombëtare 2022

Mbyllim këte muaj aplikimet për Skemën Kombëtare 2022 në të cilën Qeveria shqiptare i dedikoi zhvillimit të bujqësisë dhe ndihmës për fermerët fondin më të madh në tre dekada, prej 3,2 miliardë Lekë. Ka pasur aplikime rekord, një tregues për efikasitetin e kësaj skeme dhe rritjen e besueshmërisë së fermerëve në ndihmën për zhvillim. Këtë vit, 61,725 aplikimet për skemën e mbështetjes me natën janë rreth 130 për qind më shumë aplikime se viti i kaluar.

Paketa e Rezistencës për fermerët

Me situatën e çmimeve të karburanteve dhe ushqimeve të rritura për shkak të luftës në Ukrainë, si dhe çekullimit të të gjithë zinxhirit të furnizimit mbarrëbojtësor, qeveria shqiptare ndërtoi Paketën e Rezistencës Sociale, ku pjesë e rëndësishme e saj janë fermerët. Në kohën kur reagimi i bursave ndërkombëtare nxiti rritjen e menjëhershme të çmimit të naftës, rritim mbështetjen buxhetore edhe me 500 milionë lekë të tjera për fermerët, me natën pa taksa për punimet e mekanizurave të fermës! Me Kryeministrin Edi Rama kemi qenë në terren pranë fermerëve për t'i ndihur ata të përfitojnë nga skema e të sjellim së bashku zhvillim të mëtejshëm të bujqësisë.



SIGURIA USHQIMORE

Shqipëria, pjesë e mekanizmit të përgjigjes ndaj krizës në BE

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca takoi në Bruksel Komisionerin e Bashkimit Europian për Bujqësinë, Janusz Wojciechowski, ku diskutoi përshirjen e Shqipërisë në mekanizmin ndaj reagimit të krizës së sigurisë ushqimore, si një garanci më shumë për konsumatorin shqiptar. Ky mekanizëm është ngritur nga BE për përparatjen ndaj krizës së sigurisë ushqimore, që vjen si pasojë e luftës në Ukrainë.

Nëpërmjet këtij mekanizmi, BE është përbërë e informuar për të ndihmuar në kohë mbi krizat dhe nevojat që kanë tregjet dhe konsumatorët për lëndë të parë dhe produkte ushqimore në Shqipëri dhe në shtetet e tjera pjesëmarrëse.



VETERINARIA

Gripi i shpendëve, bashkëpunim me bashkitë për Planin e Kontingjencës

Me prejen e Shqipërisë zyrtarisht nga gripi i shpendëve në 19 mars, Ministria e Bujqësisë reagoi menjëherë duke krijuar një Grup të Menaxhimit të Emergjencës. Udhëzuesi Planin e Kontingjencës, dhe është zbatuar çdo masë izolimi e karantinimi, si dhe angazhimi i shpendëve të infektuar. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë monitoron rregullisht me rreth 600 veterinarët zyrtarë të anëtarë të gjithë territoreve vendit, dhe ka vendosur në dispozicion për fermerët numrin 0800 33 66. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, me kontrollin e përditshëm të certifikimit të produkteve dhe gjurmueshmërisë, ka garantuar se ushqimet në tregjet e licencuara nuk kanë rrezik për konsumatorin, e as konsumi i mishit dhe vezëve. Nëse qytetarët duan të denunciojnë shkelje mbari është 0800 75 75. Ministria Krifca thirrë Ministrinë e Bujqësisë kryetarët e bashkive në qarqet e prekura nga gripi i shpendëve, për bashkëpunim të veprimit dhe zbatim të Planit të Kontingjencës, në funksion të kontrollit të shtrirjes dhe izolimit të gripit në shpendëve në terrirore.



Nisim "Hënerat e Gjella" për Blegtorinë Shqiptare

Itinerare të Gjella për Blegtorinë Shqiptare është projekti më i ri i ndërtuar në bashkëpunim të ngushtë me Institutin e Blegtorisë në Francë (Institut de l'Élevage), falë mbështetjes së Qeverisë Franceze, për zhvillimin e blegtorisë në përmirësimin e sistemeve të prodhimit. Ministria Frida Krifca, së bashku me Luc Chauvel, President i Byrosë së Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Institutit vendosën piketat përfundimtare të projektit që do të sjellë eksperimente më të shquar franceze, dijen dhe teknologjinë, duke filluar nga java e dytë e Prillit.



Fuqizimi i gruas rurale dhe të rinjëve në biznese start up-e

Ministria Frida Krifca ka mbledhur në ambientet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, të rinjë dhe gra rurale nga fshatra të Shkodrës dhe Korçës, pjesë e një programi për zhvillimin rural të ndërtuar në bashkëpunim me Qeverinë Gjermane. Janë rreth 20 biznese start up-e të produkteve me bimë medicinale të krijuara nga të rinjë e gra të zonave rurale, që me ndihmën e gjithsecilit nga ne, si konsumatorë, tashmë kanë mundësinë t'ia dalin mbanë e të krijojnë ekonomi të qëndrueshme për familjet e tyre.



Tregtia rajonale, rihapet importit i grurit dhe mishit nga Serbia

Pas pezullimit të eksporteve të drithërave nga Serbia për shkak të situatës së krijuar në tregje nga lufta në Ukrainë, ministria Frida Krifca udhëtoi në Beograd, ku diskutoi hapjen e tregtisë me vendeve tona në kontekstin e marrëveshjes së Ballkanit të Hapur. Kontratat e lidhura për importin dhe eksportin e produkteve të ndryshme përfshirë mishin dhe grurin u cilruan dhe tashmë vijojnë normalisht. Ky ishte shembulli kuptimplotë se si marrëveshja e Ballkanit të Hapur funksionon për tregtinë e lirë të mallrave ushqimorë, në shërbim të vendeve tona.



info@bujqesia.gov.al
frida.krifca@bujqesia.gov.al



@mbzhr_al
@frida.krifca



@MinistriseBujqesisedheZhvillimitRural
@fridakrifca1